



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:098770
Datë: 14.10.2024
Numri i dokumentit: 06290509

C.nr. 1504/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në përbërje me gjyqtarin individual Fuad Haliti, në çështjen juridike të paditësit S.M. nga Komuna e M., të cilën sipas autorizimit përfaqëson av. Uveys Gashi, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, baza juridike, kompensim i shtesës në emër të licencimit, më datë 14.10.2024, jashtë seancës gjyqësore nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE me numër C.nr... e datës ... (...) e arritur në procedurën e ndërmjetësimit, në mes paditësit S. M. nga Komuna e M.dhe të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, baza juridike, kompensim i shtesës në emër të licencimit dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv-përmbarues.

Arsyetim

Paditësi me datën ... pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padinë për kompensimin e shtesës në emër të licencimit.

Gjykata me datën ... e ka referuar këtë çështje juridike që të zgjidhet nëpërmjet marrëveshjes në procedurë të ndërmjetësimit.

Me datën ..., gjykata është njoftuar se palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit pranë ndërmjetësuesit M B., të cilët këtë marrëveshje me shkrim i'a kanë dorëzuar gjykatës.

Gjykata, pas analizimit të shkresave të cilat gjinden në lëndë konsiderojë se janë plotësuar kushtet për aprovimin e kësaj marrëveshje të arritur në procedurën e ndërmjetësimit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 15 paragrafi 1 i Ligjit për Ndërmjetësimin “Nëse lënda është referuar nga gjykata, marrëveshja e arritur me shkrim i dërgohet gjykatës, e cila pas aprovimit, e ka fuqinë e dokumentit përmbarues sipas ligjit përkatës për procedurën përmbarimore.”

Prandaj, gjykata, bazuar në arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në dispozitivin e nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2024:098770
Datë: 14.10.2024
Numri i dokumentit: 06290509

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.1504/24, me datë 14.10.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta në ankesë.